

KONTRATE
SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 08 Prill 2019 (dymije e nentembedhjete palet e meposhtme, hartuan kontrate shitje, si me poshte vijon:

SHITESJA :

Anxhela Meta, atesia Sefedin, e datelindjes 21.07.1986, lindur ne Gramsh, banuese ne Rrugen Idriz Dollaku, Tirane, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar e pajisur me Leternjoftimin Nr 032622091 dhe Nr Personal I65721057L. me cilesine e ortakut te vetem te shoqërisë "IGOR CONSTRUCTION" SHPK, zotërues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila përfaqëson 100% te Kapitalit te shoqerise.

BLERËSI

Eduart Meta, atesia Eqerem, i datelindjes 30.10.1979, lindur Tirane, dhe banues ne Rrugen Idriz Dollaku, Tirane madhor, me zotesine e plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit Nr. personal H91030038A.

Palet e mesiperme, bazuar ne Kodin Civil te RSH, Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar me ligjin 129/2014, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe statutit te shoqerise, hartojne kete kontrate shitje si me poshte:

Shitesja Anxhela Meta eshte ortake e vetme e shoqerise "IGOR CONSTRUCTION" shpk, e cila eshte nje shoqeri shqiptare, e regjistruar si person juridik, prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 13/08/2018, me NIPT L82013003U, zotërues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila përfaqëson 100% te Kapitalit te shoqerise.

Ortaku i vetem i Shoqerise. me vendimin nr. 3 date 08 Prill 2019 ka vendosur :

1. Largimin nga shoqeria te ortakes se vetme z. Anxhela Meta dhe transferimin e kuotes se zoteruar prej saj ne shoqeri me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise, ne favor te ortakut te ri Eduard Meta, i dtl. 30.10.1979, lindur ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. personal H91030038A.

2. Largimin zj. Anxhela Meta nga detyra e administratores se shoqerise « Igor Construction » shpk

3. Emerimin ne detyren e administratorit te shoqerise "IGOR CONSTRUCTION" shpk, z. Eduard Meta, i dtl. 30.10.1979, lindur ne Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. personal H91030038A., i cili do te ushtroje kompetencat e administrimit sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare.

Objekti i kontrates

Referuar Kodit Civil te RSH, statutit te shoqerise, Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar me ligjin 129/2014, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Shitesja Anxhela Meta, transferon nepermjet shitjes 1 kuote te zoteruar prej tij ne shoqerine "IGOR CONSTRUCTION" me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise, ne favor te ortakut te ri EDUARD META,

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes se 1 kuote te zoteruara nga ortakja Anxhela Meta dhe qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate ne favor te ortakut te ri EDUARD META eshte 100 leke.

Bleresi deklaroi se ka paguar plotesisht çmimin e shitjes jashte kesaj zyre noteriale, dhe shitesja deklaroi se e ka marre çmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

Garancite

Shitesja deklaroi dhe garantoi bleresin se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes qe po transferon nepermjet kesaj kontrate dhe se ai eshte e lire nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor.

Heqje dore nga te drejtat

Shitesja deklaroi nen pergjegjesine e saj personale, se nuk ka me asnje pretendim dhe heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi zoterimin e kuotes qe po transferon nepermjet kesaj kontrate.

Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate, *shitesja Anxhela Meta, zhvishet teresisht nga zoterimi i kuotes ne shoqeri dhe largohet prej saj, ndersa bleresi EDUARD META, behet zoterues i ligjshme e 1 kuote me vlere te pergjithshme 100 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise dhe merr persiper çdo te drejte dhe detyrim qe i takon nga zoterimi i saj në shoqerine "IGOR CONSTRUCTION" Shpk*

Pjesët perberese te kontratës

Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: ekstrakti i shoqërisë, vendimi i Ortakut te vetem të Shoqërisë "IGOR CONSTRUCTION", fotokopjet e dokumenteve identifikuese.

Kjo kontratë u hartua në tre ekzemplarë me vlere të njëjta juridike.

Kontrata e mesiperme pasi iu lexua palëve, u kuptua prej tyre dhe deklaruan se janë dakort me sa më sipër, e nënshkruan regullisht. Dy kopje i merr BLERËSI dhe një kopje e mban SHITESJA.

SHITESJA
Anxhela Meta



BLERESJA
Eduard Meta

A handwritten signature in blue ink that reads "Eduard Meta". The signature is written in a cursive style and is positioned below the printed name.